



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

**RREGULLORE**

**“PËR  
ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET,  
ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME,  
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

**Miratuar me Vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë  
nr. 36, datë 29.03.2024**

**Tiranë, 2024**

---

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti i rregullores**

Kjo Rregullore përcakton rregullat për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, duke përfshirë:

- a) kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, modalitetet e zhvillimit të fushatës zgjedhore;
- b) rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore;
- c) kriteret për hartimin e listave të zgjedhësve;
- d) procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve;
- e) afatet dhe procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankimeve;
- f) administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit;
- g) kushtet dhe afatet për regjistrimin e vëzhguesve, të drejtat dhe detyrimet e tyre.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Kjo Rregullore mbështetet në Kushtetutën e RSH-së, neni 57, pika 7; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", si dhe dhe në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**Neni 3  
Fusha e veprimit**

1. Kjo Rregullore e shtrin fushën e veprimit të saj mbi të gjitha strukturat e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (këtu e më poshtë UMT), të cilat janë përgjegjëse për organizimin e procesit të zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme.
2. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë i njëjësive kryesore në UMT, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; me Statutin e UMT-së si dhe me dispozitat e parashikuara në këtë Rregullore.
3. Anëtarët e personelit akademik që kanë mbushur moshën e daljes në pension, sipas përcaktimeve në nenin 65 ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe u janë shtyrë marrëdhëniet e

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

punës përtej kësaj moshe, nuk kanë të drejtë të kandidojnë për t'u zgjedhur për post autoriteti drejtues apo anëtar në Senatin Akademik të UMT-së, si dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore, pavarësisht faktit të shtyrjes së marrëdhënieve të punës përtej moshës së pensionit.

4. Çdo student i ciklit të parë, ciklit të dytë, të ciklit të dytë të integruar dhe programeve të studimeve të specializimit afatgjatë, me kohë të plotë në UMT, ka të drejtën e zgjedhjes për autoritet drejtues dhe për anëtar të Senatit Akademik të UMT-së, për përfaqësuesit studentë. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit studentë në organet drejtuese, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore, në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Statutin e UMT-së.

**Neni 4**

**Parime të përgjithshme**

1. Zgjedhjet e përgjithshme për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë janë periodike dhe zhvillohen çdo 4 (katër) vjet.
2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas përcaktimeve në këtë Rregullore. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.
3. Çdo zgjedhës ka të drejtën e një vote të vetme për zgjedhjen e çdonjërit prej autoriteteve drejtuese ose anëtarëve të Senatit Akademik.
4. Të drejtën për t'u zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues, (Rektor dhe drejtues në njësi kryesore), e kanë edhe ata shtetas që nuk bëjnë pjesë në asamblenë e personelit akademik me kohë të plotë në një njësi kryesore, por plotësojnë kriteret për të kandiduar për këto poste, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe në këtë Rregullore.
5. Të drejtën për t'u zgjedhur si autoritet drejtues në UMT, e ka çdo anëtar i personelit akademik që nuk ka fituar në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion, dy mandate të njëpasnjëshme apo të ndara, sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (i shfuqizuar) dhe ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Në kuptim të nenit 131, pika 3 të ligjit nr. 80/2015, për arsimin e lartë, mandat i fituar konsiderohet çdo mandat që është fituar nëpërmjet një procesi zgjedhor pavarësisht nga kohëzgjatja e tij.
6. Çdo kandidat nuk mund të konkurrojë njëkohësisht për më shumë se, një post autoriteti drejtues.
7. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe zhvillojë aktivitete dhe fushatë zgjedhore për paraqitjen e programit të tij, pa cenuar procesin mësimor.
8. Shpallet i zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues, kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm.

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

9. Kur kandidon një kandidat i vetëm, ky i fundit shpallet fitues me jo më pak se 50 përqind plus një të votave të vlefshme. Nëse kandidatët nuk arrijnë të fitojnë një numër të tillë votash, 15 ditë pas ditës së zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë, pas të cilit nëse kandidati i vetëm nuk fiton 50 përqind plus një të votave të vlefshme, shpallen zgjedhje të reja.
10. Në rast se, për postin e një autoriteti drejtues nuk regjistrohet ose nuk fiton asnjë kandidat, zgjedhjet e përsëritura për këtë post zhvillohen, me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin për Rektorin dhe me urdhër të Rektorit për drejtues të njësisë kryesore/bazë dhe anëtar të Senatit Akademik, jo më parë se 6 muaj nga data e zgjedhjeve të shpallura. Zgjedhjet e përsëritura zhvillohen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe me këtë Rregullore. Gjatë periudhës kur nuk ka drejtues të zgjedhur, për caktimin e drejtuesit të njësisë veprohet sipas përcaktimeve në nenin 39, pika 9, pika 10 dhe nenin 42, pika 9 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*".
11. Zgjedhje të përsëritura zhvillohen jo më vonë se një vit përpara përfundimit të periudhës 4-vjeçare pas zgjedhjeve të fundit.
12. Në rastin kur për anëtarë të Senatit Akademik konkurrojnë më shumë kandidatë se sa numri i mandateve të caktuara për njësinë kryesore përkatëse, fitues shpallen kandidatët që fitojnë numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për anëtar të Senatit Akademik bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.
13. Në rastin kur mbeten vende vakante për anëtarë në Senatin Akademik, për arsye se numri i kandidatëve është më i vogël se numri i mandateve, në njësinë kryesore përkatëse zhvillohet një raund i dytë zgjedhjesh, 15 ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve. Për këtë raund kanë të drejtë të regjistrohen kandidatë të tjerë që i plotesojnë kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe kërkesat e kësaj Rregulloreje.

**Neni 5**

**Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve**

1. Zgjedhjet e përgjithshme për autoritetet drejtuese dhe anëtar të Senatit Akademik në UMT zhvillohen në mënyrë periodike, çdo katër vjet, sipas afateve të përcaktuara në Urdhrin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
2. Data e fillimit të procesit zgjedhor dhe data e zgjedhjeve caktohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
3. Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikon datën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zgjedhjeve, sipas përcaktimeve në urdhrin e Ministrit përgjegjës për arsimin, për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në IPAL-e.

4. Zgjedhjet për autoritetet dhe anëtar në Senatin Akademik në UMT zhvillohen brenda së njëjtës ditë.
5. Zgjedhjet jashtë radhe për autoritetet drejtuese thirren menjëherë pas përfundimit para kohe të mandatit të autoritetit drejtues përkatës, ose anëtarit të Senatit Akademik kur nuk ka të tillë në rend zbritës në listën përkatëse të të zgjedhurve, nëse pjesa e mbetur e mandatit është jo më pak se një vit.
6. Në rastin e organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për anëtarë të Senatit Akademik, autoritet drejtues në njësinë kryesore dhe autoritet drejtues në njësinë bazë, data e fillimit të procesit zgjedhor dhe data e zgjedhjeve caktohet nga Rektori i UMT-së.
7. Qendrat e votimit hapen në orën 8.00 dhe mbyllen në orën 16.00. Askush nuk mund të votojë pasi KZF (KQV) merr vendim për mbylljen e votimit. Nëse ka ende votues që presin të ushtrjnë të drejtën e tyre të votës, KZF-ja mund të marrë vendim për shtyrje të orarit të mbylljes së votimit.

## **KREU II**

### **STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE**

#### **Neni 6**

#### **Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ)**

1. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (këtu e më poshtë KIZ) është struktura përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e UMT-së.
2. Përgjedhja e anëtarëve të KIZ bëhet nga Senati Akademik i UMT-së, jo më vonë se 20 (njëzetë) ditë kalendarike para datës së fillimit të procesit zgjedhor. Senati Akademik zgjedh KIZ-in, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:
  - a) Senati Akademik përcakton numrin e anëtarëve të KIZ. Në çdo rast ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 5 (pesë), njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KIZ, përcaktohet mbi bazën e numrit të njëjësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
  - b) Senati Akademik zgjedh anëtarët e KIZ, me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij, nga lista e kandidatëve që regjistrohen në sekretarinë e Senatit. Nga Senati Akademik, caktohet dhe sekretari i KIZ-it, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni. Sekretari teknik përzgjidhet nga lista e të vetëkandiduarve për këtë pozicion, nga personeli ndihmësakademik i UMT-së.
  - c) Anëtar i KIZ nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli, si dhe nuk mund të jetë anëtar i Bordit të Administrimit.
  - d) KIZ konstituohet brenda 4 (katër) ditëve nga përzgjedhja e anëtarëve të tij nga Senati Akademik. Në mbledhjen e tij të parë, KIZ zgjedh Kryetarin me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të tij. Vendimi i konstituimit të KIZ publikohet në të gjitha mjediset dhe në faqet zyrtare të UMT-së dhe njëjësive kryesore.

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- e) Gjatë periudhës zgjedhore, KIZ mblidhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga Kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZ janë të hapura për çdo të interesuar.
  - f) Në mbledhjet e KIZ, lejohet prania e kandidatëve, vëzhguesve të kandidatëve dhe përfaqësuesve të MAS.
  - g) KIZ i merr vendimet me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të tij.
  - h) Vendimet e KIZ publikohen në mjediset e UMT-së ku është e vendosur selia e tij, jo më vonë se 12 orë pas vendimmarrjes.
3. KIZ ushtron këto kompetenca:
- a) Nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e UMT-së;
  - b) Drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor;
  - c) Emëron anëtarët e Komisioneve të Zgjedhjeve të Fakulteteve (KZF), të cilët vetëkandidojnë në KIZ;
  - d) Akrediton vëzhguesit sipas kërkesave të kandidatëve;
  - e) Vendos për numrin e qendrave të votimit për çdo njësi kryesore;
  - f) Miraton vulën për KIZ, KZF dhe vulën për kryetarin e KZF-së, si dhe të KQV- së, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi;
  - g) Regjistron kandidatët për Rektor dhe për anëtarë të Senatit Akademik;
  - h) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për Rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik;
  - i) Administron, gjykon dhe merr vendim për ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.
4. Mandati i anëtarit të KIZ-it është 4-vjeçar dhe ndërpritet në rastet kur:
- a) Kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) Ndërron jetë;
  - c) Jep dorëheqjen nga detyra;
  - d) Dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - e) Me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e KIZ dhe procesin zgjedhor;
  - f) Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tre mbledhje radhazi. Trajtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtari të KIZ në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij. KIZ merr vendim mbi këtë kërkesë, jo më vonë se 1 orë pas depozitimit të saj. KIZ merr vendim për ndërprerjen e mandatit, kur për të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi i mbetur bosh plotësohet brenda 24 orëve me vendim të Senatit Akademik;
  - g) Mbush moshën e pensionit sipas përcaktimeve në nenin 65 të ligjit nr. 80/2015;
  - h) Humbet statusin e studentit, për anëtarin përfaqësues të studentëve.
5. Sekretari teknik i KIZ përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZ. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari i KIZ është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZ.
6. Vendimet e KIZ firmosen prej të gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KIZ. Çdo anëtar i

KIZ krahas nënshkrimit të tij, mund të deklarojë në vendim votën "kundër" të arsyetuar.

7. Kandidatët për Rektor kanë të drejtë të kenë përfaqësuesin e tyre pranë KIZ, si anëtar *ex-officio*, pa të drejtë vote.

#### **Neni 7**

#### **Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete (KZF)**

1. Vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete, merret nga KIZ, jo më vonë se 3 (tre) ditë kalendarike nga dita e konstituimit të tij. KIZ zgjedh anëtarët e KZF, me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e kandidatëve që vetëkandidojnë në sekretarinë e KIZ.
2. Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KZF-së përcaktohet me vendim të KIZ, mbi bazën e numrit të njësive bazë në njësinë kryesore përkatëse. Në çdo rast, ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 3 (tre) anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Nga KIZ caktohet dhe sekretari i KZF-së, i cili është personel ndihmësakademik në njësinë kryesore dhe anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni.
3. Anëtari i KZF-së nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të cilitdo niveli, si dhe nuk mund të jetë anëtar i Bordit të Administrimit.
4. Mbledhja e parë e KZF-së zhvillohet një ditë pas vendimit të KIZ për ngritjen e tij. Në këtë mbledhje zgjidhet kryetari, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KZF-së. Përbërja e KZF publikohet në mjediset ku zhvillon aktivitetin akademik njësia kryesore përkatëse.
5. KZF mbledhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e tij janë të hapura për çdo të interesuar. Lejohet prania e kandidatëve në mbledhjet e KZF-së.
6. KZF i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të votave të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KZF-së publikohen në mjediset e njësisë kryesore, ku është e vendosur selia e tij, jo më vonë se 12 orë pas marrjes së tyre.
7. KZF ka këto kompetenca:
  - a) Përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në njësinë kryesore;
  - b) Kryen funksionet e Komisionit të Qendres së Votimit në rastin kur në njësinë kryesore ka vetëm një qendër votimi;
  - c) Emëron kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, në rast kur, me vendim të KIZ, në njësinë kryesore votimi do të zhvillohet në më shumë se një qendër votimi;
  - d) Regjistron kandidatët për drejtues të njësisë kryesore dhe drejtues të njësive bazë;
  - e) Publikon listën e zgjedhësve në mjediset e njësisë kryesore pas miratimit përfundimtar të saj;
  - f) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për drejtues të njësisë kryesore dhe drejtues të njësive bazë;
  - g) Shpall rezultatin e votimit për Rektorin dhe për anëtarët e Senatit Akademik, të cilin e dërgon në KIZ;

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- h) Merr vendim brenda kompetencave të veta mbi ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.
8. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore dhe drejtues të njërive bazë, kanë të drejtë të kenë një përfaqësues si vëzhgues në KZF dhe KQV, të cilët akreditohen prej KIZ.
9. Mandati i anëtarit të KZF-së është 4-vjeçar dhe ndërpritet në rastet kur:
- a) Kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) Vdes;
  - c) Jep dorëheqjen nga detyra;
  - d) Dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - e) Me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e KZF dhe procesin zgjedhor;
  - f) Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tri mbledhje radhazi. Shqyrtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtarit të KZF-së në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij, të cilët e paraqesin atë tek KIZ. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ, jo më vonë se 1 orë pas paraqitjes së kërkesës. Për të, duhet të votojnë "Pro" jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi i mbetur bosh plotësohet brenda 24 orëve prej KIZ.
  - g) Mbush moshën e pensionit sipas përcaktimeve në nenin 65 të ligjit nr. 80/2015;
  - h) Kur humbet statusin e studentit, për anëtarin përfaqësues të studentëve.
10. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KZF-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkojnë. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZF-së.
11. Vendimet e KZF-së firmosen prej gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KZF-së.

### Neni 8

#### Qendrat e Votimit (QV)

Pranë çdo njësie kryesore ngrihen Qendrat e Votimit me vendim të KIZ. Si rregull, çdo qendër votimi ka deri në 1000 (një mijë) zgjedhës, të të gjitha trupave zgjedhore, përfshirë studentët. Në rast se, njësia kryesore ka më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës, KIZ mund të ngrejë më shumë se një qendër votimi për atë njësi kryesore.

### Neni 9

#### Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV)

1. Në rastin kur procesi i votimit do të zhvillohet vetëm në një qendër votimi në njësinë kryesore, detyrat e komisionit të qendrës së votimit kryhen prej KZF-së. Kur KIZ ka vendosur ngritjen e më shumë se një qendre votimi në njësinë kryesore, KZF ngrë komisionet e qendrës së votimit (KQV).
2. KQV përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë, njeri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e KQV emërohen prej KZF në bazë të vetëkandidimeve.



**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

3. Vendimi për formimin e KQV-së merret prej KZF-së jo më vonë se tri ditë para ditës së votimit. Në këtë vendim caktohet edhe kryetari i KQV-së. Njëri prej anëtarëve kryen detyrat e sekretarit të KQV-së.
4. Anëtari i KQV-së nuk mund të kandidojë për asnjë post drejtues ose anëtar në organet drejtuese, si dhe nuk duhet të jetë anëtar i BA-së.
5. Komisioni i qendrës së votimit ka për detyrë vetëm organizimin, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit ditën e zgjedhjeve. Në përfundim të këtij procesi, KQV administron materialet zgjedhore, sipas procedurës dhe rregullave të caktuara në këtë Rregullore dhe ia dorëzon ato KZF-së.

**Neni 10**

**Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve**

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:
  - a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
  - b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që konstatojnë;
  - c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;
2. Vëzhguesit kanë këto detyra:
  - a) të respektojnë kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe udhëzimet e KIZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;
  - b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë fushatë zgjedhore për asnjë kandidat, në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas kësaj Rregulloreje;
  - c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KIZ, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KIZ;
  - d) të mos mbajnë shenja dalluese, që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;
  - e) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

**KREU III**

**ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE**

**Neni 11**

**Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve**

1. Në zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik kanë të drejtë të marrin pjesë:
  - a) Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë të njësive kryesore. Anëtarët e personelit akademik, që sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të kandidojnë për t'u zgjedhur si autoritete drejtuese apo në Senat Akademik dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.
- b) Studentët që ndjekin studimet në ciklin e parë, ciklin e dytë, ciklin e dytë të integruar dhe programet e studimit specializuese afatgjata, me kohë të plotë.
2. Lista e zgjedhësve për personelin akademik hartohet për çdo njësi bazë, mbi bazën e të dhënave të regjistrit të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë që administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Çdo zgjedhës identifikohet me përbërësit zgjedhorë:
- a) Emri
  - b) Atësia
  - c) Mbiemri
  - d) Datëlindja
  - e) Gjinia
  - f) Njësia bazë ku është i punësuar/programi mësimor që ndjek studentin.
3. Struktura përgjegjëse për hartimin e listës së zgjedhësve janë strukturat e burimeve njerëzore të UMT-së dhe njësitë bazë, departamentet/qendrat e kërkimit shkencor dhe për studentët sekretaritë mësimore përkatëse.
4. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë:
- a) Lista paraprake e zgjedhësve për personelin akademik të njësisë bazë hartohet nga strukturat e burimeve njerëzore, brenda 15 ditëve nga konstituimi i KIZ.
  - b) Lista paraprake dërgohet në njësinë bazë përkatëse, e cila brenda 24 orëve verifikon dhe miraton përbërjen e saj. Lista e miratuar nga përgjegjësi i njësisë bazë i dërgohet drejtuesit të njësisë kryesore, i cili e miraton dhe e shpall brenda jo më vonë se dy ditëve. Lista e miratuar afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it.
  - c) Lista e miratuar duhet të jetë e nënshkruar në çdo faqe, nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.
5. Lista përfundimtare miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore. Organ përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është sekretaria mësimore e njësisë kryesore.
6. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është si më poshtë:
- a) Lista paraprake e zgjedhësve për studentët e njësisë kryesore hartohet prej sekretarisë mësimore të njësisë kryesore jo më vonë se, 10 (dhjetë) ditë nga konstituimi i KIZ.
  - b) Lista paraprake afishohet në mjediset e njësisë kryesore.
  - c) Gjatë një periudhe deri në 7 (shtatë) ditë pas shpalljes së listës paraprake, sekretaria mësimore pranon kërkesat për korrigjime.
  - d) Pas verifikimit të kërkesës, sekretaria realizon korrigjimin e kërkuar brenda 48 orëve.
  - e) Pas përfundimit të periudhës për korrigjimin e listës, sekretaria harton listën përfundimtare e cila miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore. Lista e zgjedhësve për studentët afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it.
  - f) Lista e miratuar duhet të jetë e nënshkruar në çdo faqe, nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- g) Lista përfundimtare miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore.
7. Lista përfundimtare e zgjedhësve për personelin akademik dhe për studentët mund të korrigohet nga strukturat e sipërcituara deri në 7 (shtatë) ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Pas kësaj periudhe, zgjedhësit që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose kanë gabime në përbërësit zgjedhorë, mund të votojnë vetëm në rastin kur me kërkesën e tyre, KIZ shprehet me vendim për të marrë pjesë në zgjedhje. Afati për saktësimin e të dhënave në përbërësit zgjedhorë fillon me publikimin e listave zgjedhore dhe përfshin edhe ditën e zgjedhjeve. Zgjedhësi i pajisur me vendimin e KIZ mund të votojë vetëm me paraqitjen e këtij Vendimi në Komisionin e Qendrës së Votimit.
8. KIZ monitoron procedurat për hartimin e listës së zgjedhësve për personelin akademik dhe studentët. Për këtë qëllim, KIZ miraton një plan pune kalendar dhe cakton dy prej anëtarëve të tij për monitorimin e këtij procesi. Anëtarët përgjegjës raportojnë në mënyrë periodike në KIZ, për ecurinë e procedurave për hartimin e listës së zgjedhësve.

**Neni 12**

**Trupa zgjedhore për anëtarët e personelit akademik të Senatit Akademik**

Trupa zgjedhore për anëtarët e Senatit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore, i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje.

**Neni 13**

**Trupa zgjedhore për anëtarët studentë të Senatit Akademik**

Trupa zgjedhore për anëtarët studentë të Senatit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë përbëhet nga studentët të cilët ndjekin studimet me kohë të plotë të ciklit të parë, të dytë, të ciklit të dytë të integruar dhe programeve të studimeve të specializimeve afatgjata, në UMT.

**Neni 14**

**Trupa zgjedhore për Rektorin**

Trupa zgjedhore për Rektorin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë përbëhet nga:

- i. personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore, sipas përcaktimeve në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje.
- ii. studentët sipas përcaktimeve në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje. Votat e studentëve në përzgjedhjen e Rektorit llogariten në masën 10 (dhjetë) përqind të totalit të përgjithshëm të votave.

**Neni 15**

**Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore**

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë përbëhet

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

nga:

- i. personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore, sipas përcaktimeve në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje.
- ii. studentët sipas përcaktimeve në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje, në atë njësi kryesore. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit të njësisë kryesore llogariten në masën 10 (dhjetë) përqind të totalit të përgjithshëm të votave.

**Neni 16**

**Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë**

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë bazë, sipas përcaktimeve në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje.

**Neni 17**

**Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore**

Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore, sipas përcaktimeve në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 11 të kësaj Rregulloreje.

**KREU IV**

**REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE DHE FUSHATA ZGJEDHORE**

**Neni 18**

**Regjistrimi kandidatëve**

1. Procesi i regjistrimit i kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë fillon datën e shpalljes nga komisioni zgjedhor përkatës dhe përfundon në orën 16.00 të ditës së pestë kalendarike.
2. Data për fillimin e regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe për anëtarë të Senatit Akademik shpallet prej KIZ, 2 (dy) ditë kalendarike pas ditës së konstituimit të tij.
3. Data për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve për drejtues të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë shpallet prej KZF-së 2 (dy) ditë kalendarike pas ditës së konstituimit të tij.
4. Mosregjistrimi i kandidatëve për Rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik bëhet me vendim të arsyetuar nga KIZ. Vendimi i KIZ për mosregjistrim të kandidatëve, është i ankimueshëm pranë Komisionit të Apelimit.
5. Mosregjistrimi i kandidatëve për drejtues të njësisë kryesore ose të njësisë bazë bëhet me vendim të arsyetuar nga KZF. Vendimi i KZF për mosregjistrim të kandidatëve, është i ankimueshëm pranë KIZ.

### **Neni 19**

#### **Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar në Senatin Akademik**

1. Kandidatët për anëtarë të Senatit Akademik, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UMT-së dhe në këtë Rregullore.
2. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të kandidatëve me titujt dhe gradat e mësipërme dhe për efekt përfaqësimi, kandidatët për anëtarë duhet të kenë së paku gradën shkencore "Doktor".
3. Kandidatët për anëtarë të Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i përkasin kategorisë student të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të ciklit të dytë të integruar dhe programeve të studimeve të specializimeve afatgjata. Në momentin e kandidimit, ata duhet të kenë mesataren aritmetike mbi 8 (tetë) të vitit/viteve paraardhës/paraardhëse. Në rastet kur një student i zgjedhur në Senatin Akademik përfundon studimet universitare ose humbet statusin e studentit, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje, për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.
4. Nuk mund të kandidojnë për anëtar të Senatit Akademik, anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë apo studentët që:
  - a) Nuk gëzojnë statusin e studentit në momentin e kandidimit.
  - b) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
  - c) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - d) Janë të dënuar më parë për vepra penale;
  - e) Kanë masë disiplinore në fuqi;
  - f) Nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) për:
    - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj Rregulloreje;
    - ii. garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 138/2015.

### **Neni 20**

#### **Kriteret për Rektor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë**

1. Kandidatët për Rektor të UMT-së, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, Statutin e UMT-së dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Kandidatët për Rektor, duhet të mbajnë titullin "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të UMT-së ose jashtë tij.
3. Kandidatët për Revktor vetëkandidohen dhe duhet të plotësojnë dhe kriteret e mëposhtme:

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- a) Të kenë përvojë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në fushën e shkencave të shëndetit jo më pak se 20 (njëzet) vjet;
  - b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
  - c) Të mos jenë dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale;
  - d) Të mos kenë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008, "*Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve*" dhe ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*".
4. Nuk mund të kandidojnë për Rektor të UMT-së, kandidatët që:
- a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
  - b) Kanë qenë Rektor të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përlllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar (i shfuqizuar) dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes.
  - c) Kanë mbushur moshën për pension sipas përcaktimeve në nenin 65 të ligjit nr. 80/2015 për arsimin e lartë.
  - d) Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.
  - e) Nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) për:
    - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj Rregulloreje;
    - ii. garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 138/2015.

**Neni 21**

**Kriteret për drejtues të njësisë kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë**

1. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UMT, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Statutin e UMT-së, si dhe në këtë Rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në UMT, duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose nga jashtë tij.
3. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore, vetëkandidohen dhe duhet të plotësojnë dhe kriteret e mëposhtme:
  - a) të ketë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
  - b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
  - c) të mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
  - d) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 "*Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve*" dhe ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*".

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

4. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, kandidatët që:
- a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
  - b) Kanë qenë drejtues të njësisë kryesore të zgjedhur për dy ose me shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përlllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i shfuqizuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes;
  - c) Kanë mbushur moshën për pension sipas përcaktimeve në nenin 65 të ligjit nr. 80/2015;
  - d) Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.
  - e) Nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) për:
    - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj Rregulloreje;
    - ii. garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 138/2015.

**Neni 22**

**Kriteret për drejtues të njësisë bazë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë**

1. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UMT, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UMT-së, si dhe në këtë rregullore.
2. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në UMT, janë personel akademik me kohë të plotë të njësisë bazë që i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore "Doktor".
3. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, duhet të plotësojnë dhe kriteret e mëposhtme:
  - a) të jetë personel akademik me kohë të plotë prej së paku 5 (pesë) vite në njësinë bazë përkatëse;
  - b) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale;
  - c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
  - d) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"
4. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë bazë në UMT, kandidatët që:
  - a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
  - b) Kanë qenë drejtues të njësisë bazë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj dispozite, përlllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007,

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, (i shfuqizuar) dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes.
- c) Kanë mbushur moshën për pension sipas përcaktimeve në nenin 65 të ligjit nr. 80/2015.
  - d) Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.
  - e) Nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) për:
    - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj Rregulloreje;
    - ii. garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 138/2015.

**Neni 23**

**Kriteret për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë**

1. Zgjedhjet për anëtarë në komisionet e përhershme në UMT janë periodike dhe zhvillohen çdo 2 (dy) vjet.
2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas përcaktimeve në këtë Rregullore. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.
3. Kandidatët për anëtarë në komisionet e përhershme, vetëkandidohen.
4. Kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin e UMT-së dhe në këtë rregullore
5. Numri i komisioneve dhe vendeve për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përcaktohen në Statutin e UMT-së ose nga Senati Akademik i UMT, por jo më pak se pesë anëtarë për secilin komision.
6. Kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme, vijnë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë të UMT-së. Në përbërje të komisioneve të përhershme përfaqësohen edhe studentët, sipas përcaktimeve të Statutit të UMT-së, me përjashtim të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në rastet kur institucioni e gëzon të drejtën për ngritjen e këtyre komisioneve.
7. Nuk mund të kandidojnë për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, kandidatët që:
  - a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
  - b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - c) Janë të dënuar më parë për vepra penale;
  - d) Kanë masë disiplinore në fuqi.
  - e) Nuk dorëzojnë formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ-it) për:
    - i. për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj Rregulloreje;
    - ii. garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 138/2015.



**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

8. Rastet e ndërprerjes para kohe të mandateve përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi.
9. Përgatitja e listës së zgjedhësve, regjistrimi i subjekteve dhe fushata zgjedhore, vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe vendeve të numërimit të votave, votimi, shpallja e rezultateve dhe ankimi, bëhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, për aq sa është e mundur.

**Neni 24**  
**Kandidimi**

1. Kandidatët për autoritete drejtuese të të gjithë niveleve dhe për anëtarë në Senatin Akademik vetëkandidohen.
2. Kandidatët për Senatin Akademik, përfaqësues të studentëve, propozohen nga jo më pak se 30 studentë, pjesë e trupës zgjedhore.
3. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Statutit të UMT-së dhe kërkesat e kësaj Rregulloreje.

**Neni 25**  
**Dokumentacioni për kandidim**

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZ/KZF dhe përmban:
  - a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
  - b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
  - c) Vetëdeklarimin se, kandidati nuk ka fituar dy mandate të njëpasnjëshme ose të ndara, sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
  - d) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
  - e) Vetëdeklarimin se, nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emerohen ose ushtrojnë funksione publike*" dhe ligjit nr. 45/2015 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*";
  - f) Kopje të noterizuar të titullit akademik/gradës shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-se ose BE-së, të njohur në RSH;
  - g) Vetëdeklarimi për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
  - h) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar dhe eksperiencën e tij në mësimdhënie ose kërkim shkencor (*të shprehur edhe në vite*).
2. Dokumentet e kandidimit për studentët dorëzohen në KIZ, dhe përmbajnë:
  - a) Kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe

- shprehjen e vullnetit për kandidim.
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
  - c) Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
  - d) Propozimin nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore;
3. Pas verifikimit të dokumentacionit KIZ, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për Rektor dhe të kandidatëve për Senatin Akademik. Listat shpallen publikisht në mjediset ku ka selinë KIZ i UMT.
  4. Pas verifikimit të dokumentacionit, KZF, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidateve për drejtues të njësisë kryesore dhe listën e kandidatëve për drejtues të njësisë bazë për secilën prej njësive respektive. Listat shpallen publikisht në mjediset e njësive kryesore.
  5. Pas regjistrimit, çdo kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat prej komisionit zgjedhor që kryen regjistrimin e tij. Forma e këtij vërtetimi miratohet me vendim të KIZ.

#### **Neni 26**

##### **Kohëzgjatja e mandateve për strukturat zgjedhore**

Organet dhe autoritetet drejtuese zgjidhen për një mandat 4-vjeçar, Rastet e ndërprerjes së mandateve përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi. Mandati i anëtarëve të KA, të KIZ, dhe të KZF është 4-vjeçar.

#### **Neni 27**

##### **Përfaqësimi i njësive kryesore në Senatin Akademik**

Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në të njëjtën ditë që do të zgjedhë anëtarët e KIZ, vendos për numrin e përfaqësuesve të secilës njësi kryesore në Senatin Akademik të ardhshëm, sipas përcaktimeve në nenet 33 dhe 37 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*". Numri i përfaqësuesve duhet të jetë numër tek. Numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik për studentët duhet të jetë në masën 10 (dhjetë) përqind të numrit të anëtarëve të Senatit Akademik.

#### **Neni 28**

##### **Fushata zgjedhore**

1. Fushata zgjedhore fillon një muaj përpara datës së zhvillimit të zgjedhjeve sipas Urdhrit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet zhvillimi i fushatës zgjedhore.
3. Administratori/ët dhe administrata e institucionit duhet t'u krijojë kushte të përshtatshme dhe të barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

zgjedhore. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e institucionit merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, jashtë orëve të mësimit që zhvillohen në institucion.

**KREU V**  
**PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT PËR ZGJEDHJET**

**Neni 29**

**Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe vendeve të numërimit të votave**

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
  - a) Selia e KIZ vendoset në godinën ku ndodhet administrata qendrore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
  - b) Selia e KZF-së vendoset në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore.
2. Vendet e numërimit të votave (VNV) përcaktohen sipas rregullit të mëposhtëm:
  - a) Votat për Rektor, drejtuesin e njësisë kryesore, drejtuesin e njësisë bazë dhe për anëtar të Senatit Akademik, numërohen në një sallë në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore.
  - b) Vendet e numërimit të votave duhet të jenë salla me përmasa të mëdha, të cilat të krijojnë mundësinë për zhvillimin normal të procesit të numërimit të votave. Organizimi i sallës për numërimin votave duhet të bëhet i tillë që t'iu japë mundësi përfaqësuesve të MAS, vëzhguesve dhe kandidatëve të vëzhgojnë procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave.
3. Sallat e numërimit të votave duhet të jenë të pajisura me kamera monitorimi, të cilat duhet të regjistrojnë në mënyrë të pandërprerë 24 orë të gjithë veprimtarinë e numërimit të votave.

**Neni 30**

**Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave**

1. Votat për Rektor, anëtarë të Senatit Akademik të UMT-së, drejtues të njësisë kryesore dhe drejtues të njësisë bazë, vlerësohen dhe numërohen prej KZF-së.
2. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZF plotëson tabelat zgjedhore për secilën kategori dhe ia përcjell KIZ.
3. Pas përfundimit të afateve për ankimimin, KIZ shpall fituesit sipas përcaktimeve në këtë Rregullore.

**Neni 31**

**Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor**

1. Për zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik, personeli akademik voton me 4

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- (katër) fletë me ngjyra të ndryshme:
- a) Fletë votimi për Rektor;
  - b) Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore;
  - c) Fletë votimi për drejtues të njësisë bazë;
  - d) Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik;
2. Për zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik, studentët votojnë me 3 (tre) fletë votimi me ngjyra të ndryshme:
- a) Fletë votimi për Rektor;
  - b) Fletë votimi për drejtues të njësisë kryesore;
  - c) Fletë votimi për anëtarë të senatit akademik, përfaqësues i studentëve;
3. Numri i fletëve të votimit është i barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 (dy) përqind.
4. Fleta e votimit përgatitet prej KIZ. Fleta e votimit duhet të jetë prej letre, me ngjyrë dhe trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Fletët e votimit prodhohen në blloqe, pa kundërfletë me numra serial unikë sipas kategorisë. Informacioni që duhet të përmbajë fleta e votimit është:
- a) Në krye të fletës së votimit vendoset emërtesa për të cilin do të përdoret;
  - b) Emërtimi i autoritetit drejtues ose Senati Akademik;
  - c) Emri, atësia, mbiemri për kandidatët e regjistruar për autoritetin ose organin drejtues përkatës, të cilët renditen sipas rendit alfabetik;
  - d) Në rastin kur për postin e një autoriteti drejtues ose anëtar të Senatit Akademik është regjistruar dhe konkurron vetëm një kandidat, në fletën e votimit krahas emrit të tij vendosen alternativat për votim "Pro" ose "Kundër";
  - e) Fleta e votimit për studentët në sfond të saj ka të shkruar "Për student".

**Neni 32**

**Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZ në KZF**

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve, KIZ dërgon në KZF materialet zgjedhore, si më poshtë:
  - a) Fletët e votimit për personelin akademik dhe për studentët, në përputhje me numrin e votuesve në njësinë kryesore të UMT;
  - b) Listën e zgjedhësve për personelin akademik dhe listën e zgjedhësve për studentët;
  - c) Vulën e kryetarit të KZF-së;
  - d) Vulën e KQV-së, në rast se në njësinë kryesore do të ketë më shumë se një qendër votimi.
  - e) Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
  - f) Zarfën në të cilin është shënuar "Fletë votimi të dëmtuara";
  - g) Zarfën në të cilin është shënuar "Fletë votimi të papërdorura";
  - h) Zarfën në të cilin është shënuar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes";
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore në KZF, dërgohen edhe kutitë e votimit:
  - a) Kutia e votimit për Rektor;

- b) Kutia e votimit për drejtues të njësisë kryesore;
- c) Kutia e votimit për drejtues të njësisë bazë;
- d) Kutia e votimit për anëtarët e Senatit Akademik nga personeli akademik i njësisë kryesore;
- e) Kutia e votimit për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve;
- f) Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZF-së;
- g) Tabelat për rezultatin e zgjedhjeve për secilën kategori;
- h) Dhomat e fshehta;
- i) Vulat me kodet e sigurisë.

## **KREU VI VOTIMI**

### **Neni 33**

#### **Veprimet paraprake për hapjen e qendrës së votimit**

1. Nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit, KZF kryen këto detyra:
  - a) vendos tryezat, karriget, dhomën e fshehtë dhe kutitë e votimit në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, si dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
  - b) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
  - c) kontrollojnë të gjitha materialet e marra në dorëzim;
  - d) u tregon vëzhguesve kutitë e votimit të zbrazëta. Në faqen e përparme të çdo kutie votimi vendoset emërtimi për autoritetin që do të votohet me ngjyrë të njëjtë me atë të fletës përkatëse të votimit.
  - e) mbyll kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe i shkruan këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Procesverbali mbyllet në zarfin ku është shkruar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes", i cili futet në kutinë e votimit për Rektor para fillimit të procesit të votimit.
2. Anëtarët e KZF në prani të kandidatëve/vëzhguesve dhe përfaqësuesve të MAS, në rast se paraqiten, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.
3. Të njëjtat veprime kryen edhe nga KQV-ja në rastin kur në njësinë kryesore votimi kryhet në më shumë se një qendër votimi.

### **Neni 34**

#### **Procedurat e votimit**

1. Votimet për autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve dhe Senatit Akademik në UMT zhvillohen në një ditë të vetme, në datën e caktuar nga Ministri përgjegjës për arsimin.
2. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullorë, kryetari i KZF-së (KQV) deklaron hapjen e votimit jo më përpara se ora 8:00.

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

3. Sekretari shënon në Librin e Protokollit të KZF-së (KQV) kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtarit të komisionit prej qendrës së votimit. Kur kryetari largohet nga qendra e votimit, ai ia kalon vulën e kryetarit për përdorim një anëtarit të komisionit.
4. Fletët e votimit vulosen, në pjesën e pasme, në vendin e caktuar me vulën e KZF- së, të cilat mbajnë respektivisht shkrimin "KZF-kryetar dhe emrin e Njesisë kryesore/Njesisë Bazë".
5. Në qendrën e votimit vendosen kuti votimi në numër të barabartë me numrin e autoriteteve drejtuese, Rektor, për drejtues të njesisë kryesore dhe për përgjegjës departamenti, për të cilat kryhet votimi në njësinë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe dy kuti për Senatit Akademik, një për anëtarët e Senatit nga personeli akademik dhe një për anëtar Senatit përfaqësues i studentëve.
6. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtarit të komisionit. Pasi hyn në qendrën e votimit:
  - a) zgjedhësi thotë emrin e tij, nëse është personel akademik apo student, njësinë bazë ku bën pjesë dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike:
    - i) Letërnjoftim;
    - ii. Pasaportë.
  - b) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
  - c) zgjedhësi që është pajisur nga KIZ me vendim për të votuar pasi hyn në qendër e paraqet atë tek kryetari i qendrës. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohet në një regjister të veçantë;
  - d) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
  - e) zgjedhësit-personel akademik, i jepen për të votuar fletët e votimit për Rektor, për drejtues të njesisë kryesore, për përgjegjës departamenti në të cilin bën pjesë dhe fleta e votimit për anëtarë të personelit akademik në Senatit Akademik;
  - f) zgjedhësit-studentit, i jepen për të votuar fletët e votimit për Rektor, për drejtues të njesisë kryesore, për anëtarë në Senatit Akademik përfaqësues i studentëve;
  - g) çdo fletë e votimit vuloset, në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF /KQV-së.
  - h) pasi merr fletët e votimit zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe:
    - i. në fletën e votimit për Rektor, për drejtues të njesisë kryesore dhe për drejtues të njesisë bazë, shënon në krah të emrit të kandidatit shenjën "x"/ "+"/"√" ose ndonjë shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkuron vetëm një kandidat zgjedhësi voton një nga alternativat e shkruajtura krahas emrit të kandidatit "Pro" ose "Kundër";
    - ii. në fletën e votimit për anëtarë të Senatit Akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve shenjën "x"/ "+"/"√" ose ndonjë shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Zgjedhësi duhet të shënojë jo më shumë emra se sa është numri i mandateve në Senatit Akademik që i përkasin njesisë kryesore përkatëse. Në rast të zgjedhjes të më

shumë emrave se sa është numri i mandateve që i përkasin njësisë kryesore përkatëse në Senatin Akademik, fleta e votimit bëhet e pavlefshme.

- iii. pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit;
- i) Nëse shënimin në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i qendrës e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E dëmtuar" dhe e fut atë në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara". Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletëvotimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi të dytë. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.
- j) Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës. Në qendrën e votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
  - i. anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
  - ii. zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
  - iii. vëzhguesit e akredituar;

### **Neni 35**

#### **Mbyllja e votimit**

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën e caktuar 16.00. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari, ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë, nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.
2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar dhe kandidatët.

**Neni 36**

**Veprimet pas mbylljes së qendrës së votimit**

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari së bashku me anëtarët e KZF/KQV-së kryejnë, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
2. Kryetari në prani të të gjithë anëtarëve;
  - a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar nga personeli akademik dhe studentë, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, si dhe atyre që janë në regjistrit e veçantë, që kanë votuar sipas kushteve të parshikuara në këtë rregullore.
  - b) ia deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të Komisionit dhe vëzhguesve të pranishëm;
  - c) i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij;
  - d) urdhëron sekretarin e komisionit të shënojë në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e personave që kanë votuar në qendrën e votimit. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
3. Kryetari në prani të të gjithë anëtarëve, pasqyron në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, për secilën prej kategorive, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KIZ, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara për secilën kategori.
4. Kryetari në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura për secilën prej kategorive dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrat anëtarëve të komisionit. Nëse kërkohet nga një anëtar i komisionit ose ndonjë nga vëzhguesit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të papërdorura. Në përfundim të numërimit, fletët e votimit të papërdorura mbylhen në zarfin ku është shënuar "Fletë votimi të papërdorura" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Kryetari në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
6. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, futen:
  - a) në kutinë e materialeve zgjedhore për zgjedhjen e Rektorit:
    - i. zarfi "Fletë votimi të papërdorura për zgjedhjen e Rektorit";
    - ii. zarfi "Fletë votimi të dëmtuara për zgjedhjen e Rektorit";
    - iii. Procesverbalin për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara.
  - b) Për secilën kategori veprohet në të njëjtën mënyrë.
7. Elementët e sigurisë për mbylljen e këtyre kutive shënohen në procesverbal dhe më pas mbyllet kutia e votimit.
8. Kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore përkatëse dërgohet në KIZ. Kutitë shoqërohen nga dy anëtarë të KZF dhe mund të shoqërohen edhe nga vëzhguesit e kandidatëve.
9. Në rastin kur në njësinë kryesore votimi është kryer në më shumë se një qendër votimi,



komisioni i qendrës së votimit pas administrimit të materialeve zgjedhore sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen, i dorëzon ato së bashku me kutinë e votimit për Rektor në KZF, e cila është përgjegjëse për transportin e tyre në KIZ.

### **Neni 37**

#### **Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për zgjedhjen e Rektorit, drejtuesit në njësinë kryesore, drejtuesit në njësinë bazë dhe për anëtarë në Senatin Akademik**

1. Procedurat për vlerësimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit për zgjedhjen e Rektorit, drejtuesit në njësinë kryesore, drejtuesit në njësinë bazë dhe për anëtarë në Senatin Akademik kryhen prej KZF-së, në një sallë të caktuar prej saj dhe që ndodhet në mjediset e njësisë kryesore.
2. Në rastin kur procesi i votimit është kryer në më shumë se një qendër votimi në njësinë kryesore, Komisioni i qendrës së votimit, pasi ka përfunduar administrimin e materialeve zgjedhore sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje, i dorëzon ato në sallën e numërimit të votave, KZF-së. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit bëhet me procesverbal.
3. Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve zhvillohet sipas radhës së mëposhtme:
  - a) Rektor;
  - b) Drejtues i njësisë kryesore;
  - c) Drejtues i njësisë bazë;
  - d) Anëtarë të Senatit Akademik (personel akademik dhe studentë);
4. Kryetari hap kutinë e votave për Rektor, nxjerr nga kutia fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj:
  - a) vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të komisionit dhe vëzhguesve. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë.
  - b) numëron votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal.
  - c) verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetur në kuti me numrin e votave që duhet të ishin në kuti në bazë të të dhënave të procesverbalit të KZF/KQV-së për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletët e votimit të papërdorura dhe fletët e votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal.
  - d) ndan në grupe të veçanta votat e hedhura nga personeli akademik dhe nga studentët dhe i numëron votat e secilit grup. Numri i tyre shënohet në procesverbal.
  - e) ndan votat e personelit akademik në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal.
  - f) ndan votat e studentëve në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal.
  - g) harton tabelën përfundimtare për votimin në njësinë kryesore përkatëse dhe e miraton me vendim.
5. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit në rastet e mëposhtme:
  - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

nga KIZ;

- b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në këtë Rregullore;
  - c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
  - d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
  - e) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
  - f) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
  - g) nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.
  - h) në rast të zgjedhjes së më shumë kandidatëve, se sa është numri i mandateve që i përkasin njësisë kryesore përkatëse në Senatit Akademik.
6. Në rast se në njësinë kryesore është votuar në më shumë se një qendër votimi, KZF vlerëson dhe numëron votat për secilën qendër votimi sipas procedurës së përshkruar më sipër.
  7. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave për Rektor, KZF harton tabelën e rezultatit të votave për Rektor. Kopje e tabelës të rezultatit të votave për Rektor u jepet, sipas kërkesës, vëzhguesve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të MAS-së.
  8. Në rastin kur nuk ka asnjë fitues, KIZ, në përputhje me përcaktimet e kësaj Rregulloreje, merr vendim për organizimin dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.
  9. KZF vazhdon procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë dhe për anëtarët e Senatit Akademik, duke ndjekur për aq sa është e nevojshme procedurën e përshkruar në këtë nen.
  10. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZF harton tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit dhe shpall me vendim të veçantë rezultatet për secilën kategori. Tabela përfundimtare dhe vendimi i KZF-së, nënshkruhen nga të gjithë anëtarët duke deklaruar votën "pro" apo "kundër" dhe vulosen nga sekretari. Kopje të tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve ju jepet sipas kërkesës, vëzhguesve të kandidatëve.
  11. Mënyra e përlogaritjes së votave për autoritetet drejtuese për të cilët votojnë dhe studentë, do të jetë:  
$$R\% = \frac{A}{N_1} * 90\% + \frac{B}{N_2} * 10\%$$

R% - është rezultati i shprehur në përqindje i një kandidati për një pozicion të caktuar;  
A - është numri i votave pro kandidatit nga personeli akademik;  
N<sub>1</sub> - është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga personeli akademik;  
B - është numri i votave pro kandidatit nga studentët;  
N<sub>2</sub> - është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga studentët.
  12. Vendimet e KZF për tabelat e rezultateve të zgjedhjeve ankimohen në KIZ.
  13. Gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave në vendin e numërimit të votave kanë të drejtë të qëndrojnë anëtarët dhe sekretari i KZF-së, kandidatët dhe vëzhguesit e tyre të akredituar.
  14. Çdo kontestim i kandidatëve apo vëzhguesve të tyre, shënohet detyrimisht në librin e procesverbaleve nga sekretari i KZF-së.

**Neni 38**  
**Ankimet**

1. Çdo kandidat pjesëmarrës në zgjedhjet për autoritete drejtuese ose anëtar në Senatin Akademik ka të drejtë të ankohet në KIZ kundër vendimeve të KZF-së që cenojnë interesat e tij, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike, nga data e shpalljes së vendimit.
2. Kundër vendimeve të KZF-së për shpalljen e tabelave të rezultatit, tabelave përmbledhëse të rezultatit dhe rezultatit të zgjedhjeve, ankimi bëhet në KIZ jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike, nga data e shpalljes së tyre.
3. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha dy ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së vendimit/aktit për të cilin bëhet ankimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendarike.
4. KIZ administron dhe merr vendim për ankimet për çështje që nuk lidhen me rezultatin e zgjedhjeve jo më vonë se, 24 orë pas paraqitjes së tyre.
5. KIZ administron dhe merr vendime për ankimet për rezultatin e zgjedhjeve jo më vonë se, 48 orë pas paraqitjes së tyre.
6. Çdo vendim i KIZ është i ankimueshëm në Komisionin e Apelimit (KA), brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së vendimit. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 5 ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së vendimit/aktit për të cilin bëhet ankimi dhe përfundon në orën 16:00 të ditës së fundit. Komisioni i Apelimit shprehet me vendim të arsyetuar brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike.

**Neni 39**  
**Komisioni i Apelimit**

1. Komisioni i Apelimit (KA) është struktura zgjedhore përgjegjëse për trajtimin e ankimeve sipas kësaj Rregulloreje.
2. KA përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët përzgjidhen me short nga Senati Akademik i UMT.
3. Kandidatët e interesuar për anëtarë të KA, vetëkandidojnë pranë Senatit Akademik të UMT, sipas përcaktimeve në vendimin e Senatit Akademik.
4. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që:
  - a) Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet, me kohë të plotë;
  - b) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
  - c) Nuk kanë lidhje gjinore në vijë të drejtë ose të tërthortë, deri në shkallë të katërt, me kandidatë që konkurrojnë në zgjedhje. Në rast konstatimi të tillë, anëtari dorëhiqet menjëherë dhe zëvendësohet nga Senati Akademik me short.
5. Në mbledhjen e parë, Komisioni i Apelimit, zgjedh Kryetarin dhe Sekretarin e tij, me shumicën e thjeshtë të votave.
6. Rregullat për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Apelimit hartohen dhe vendosen prej këtij komisioni, menjëherë pas konstituimit të tij dhe zgjedhjes të kryetarit dhe sekretarit.
7. Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- mendimet "kundër", për çdo ankim ndaj vendimeve të marra prej KIZ.
8. Vendimi i Komisionit të Apelimit është i formës së prerë, përfundimtar, i detyruar për t'u zbatuar.
  9. Kundër vendimeve të Komisionit të Apelimit, i interesuari mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

**Neni 40**

**Pavlefshmëria e zgjedhjeve**

1. KIZ, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë njësi kryesore, në rast se:
  - a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;
  - b) mund të jetë cenuar procesi zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
  - c) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim;
  - d) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se 5 (pesë) orë.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkuesi duhet ta shoqërojë me shpjegimin për shkaqet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar.
3. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën, bëhet nga KIZ, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendrike nga depozitimi i saj.
4. Pas vendimit për pavlefshmëri të zgjedhjeve, shpallen zgjedhje të reja sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, Statutit të UMT-së dhe kësaj Rregulloreje.

**Neni 41**

**Dispozita të fundit**

1. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimeve në Komisionin e Apelimit, KIZ shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për autoritete drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
2. Data e mbledhjes së parë të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, caktohet nga Rektori 15 ditë pas dekretimit të tij nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Kjo datë shënon edhe përfundimin e mandatit të Senatit të mëparshëm dhe fillimin e punës së Senatit të ri Akademik.
3. KIZ i përcjell Ministrit të Arsimit dhe Sporteve vendimin për shpalljen e fituesit Rektor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Ministri i Arsimit dhe Sporteve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procesit zgjedhor, i përcjell Presidentit të Republikës vendimin e KIZ për shpalljen e fituesit për pozicionin Rektor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Rektori i zgjedhur dhe dekretuar, emëron drejtuesit e zgjedhur të njërive kryesore të institucionit të arsimit të lartë publik, brenda muajit të parë të dekretimit të tij.
5. Dekani i zgjedhur i njësisë kryesore emëron drejtuesit e zgjedhur të njërive bazë, brenda muajit

**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

- të parë të emërimit të tij.
6. Si rregull anëtari/ët e zgjedhur në organet drejtuese duhet të japin dorëheqjen e tyre në momentin që përfundojnë marrëdhëniet e punës me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë si dhe kur humbasin statusin e studentit. Anëtari depoziton kërkesën e tij për dorëheqje pranë në organin drejtues që është zgjedhur.
  7. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivën e institucionit, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit.
  8. Monitorimi i procesit zgjedhor në të gjithë komisionet zgjedhore apo qendrat e votimit, realizohet nga vëzhguesit e akredituar të kandidatëve, kandidatët kur është e lejuar si dhe subjektet e tjera të përcaktuara në këtë Rregullore.
  9. Anëtarët dhe sekretari i Komisionit të Apelimit, KIZ-së, KZF-ve dhe KQV-ve, si dhe personeli i UMT-së i cili me Urdhër të titullarit ndihmon në zhvillimin e procesit zgjedhor, shpërblehen për punën e kryer. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
  10. Kjo Rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjithë strukturat e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
  11. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të UMT-së dhe njësisve kryesore, si dhe një kopje e saj depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

**KRYETAR**  
**PROF. DR. ARBEN GJATA**



**RREGULLORE "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**Shtojca nr.1**

**FORMULAR DEKLARIMI**

**Mbi zbatimin e rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e perhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"**

Deklaruesi: \_\_\_\_\_  
(emër) (atësi) (mbiemër)

Pozicioni: \_\_\_\_\_  
(brenda UMT-së/ jashtë UMT-së)

Vendi i Punës: \_\_\_\_\_

Në mbështetje të nenit 19, 20, 21, 22 dhe 23 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e perhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", unë Z./Znj. \_\_\_\_\_, kandidat për \_\_\_\_\_, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj për mungesën e plagjaturës në punimet për fitimin e Gradës shkencore "Doktor" / Titullin akademik "Porofesor i asociuar"/"Profesor".

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Nënshkruesi \_\_\_\_\_

Tiranë më: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024